

VENDIM
Nr. 347, datë 12.6.2018

**PËR NJË SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT, MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË DHE MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR
PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË
ÇËSHTJET E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2018 bëhet një shtesë fondesh, si më poshtë vijon:
 - a) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlefata në lekë e fondit 516 146 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) euro dhe 99 660 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) paundë për kryerjen e pagesave të faturave të firmës avokatore “Gowling WLG” në çështjen e Arbitrazhit Ndërkombëtar “ICSID, nr. Arb/14/26”, me palë “Albaniabeg Ambient, sh.p.k”, “M.Angelo Novelli” dhe “Costruzioni S.R.L.” kundër Republikës së Shqipërisë;
 - b) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlefata në lekë e fondit 1 000 000 (një milion) euro për kryerjen e pagesave të shërbimeve juridike në çështjen e Arbitrazhit Ndërkombëtar “ICSID case no.ARB/17/6” me palë “Anglo-Adriatic Group Limited” kundër Republikës së Shqipërisë;
 - c) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin “Mbështetje për energjinë”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlefata në lekë e fondit 600 000 (gjashtëqind mijë) euro për kryerjen e pagesave të faturave të firmës avokatore “Gowling WLG” për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e Arbitrazhit Ndërkombëtar “ICC kundër Hydro S.R.L.”.
 2. Efekti financiar, i parashikuar në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.
 3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama